



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ  
KRYETARI

Nr. .... Prot

Maliq, më 25.01.2024

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

**PROJEKT VENDIM** - nr. 10

**“Për miratimin e krijimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike, Rregulloren dhe menyrën e funksionimit të këshillit vendor për sigurinë publike”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar nenit 54 neni 8, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b” “Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit Bashkiak”, pika k, neni 64 “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë” pika “c” si dhe pika 2 e nenit 78 dhe 79 të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe në shkresën e Ministrisë së Brendshme nr. 176/6 Prot, datë 05.03.2018, me lëndë : Për krijimin e këshillave vendor për sigurinë publike. I propozoj Këshillit të Bashkisë,

1-Të miratojë krijimin e këshillit vendor për sigurinë publike, së bashku me rregulloren përpërberjen, detyrat, përgjegjësitë dhe menyrën e funksionimit të këshillit vendor për sigurinë publike bashkëngjitur këtij projekt-vendimi.

2- Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, si drejtues i Këshillit Vendor për Sigurinë Publike.

3- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETARI I BASHKISË  
Gëzim Topçiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ  
KRYETARI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_ Prot

Maliq më 28/01/2024

**RREGULLORE**

**PËR**

**PËRBËRJEN, DETYRAT, PËRGJEGJËSITE DHE MENYRËN E FUNKSIONIMIT TË  
KËSHILLIT VENDOR PËR SIGURINË PUBLIKE**

## Neni 1

Hyrje :

*Disa të dhëna për popullsinë dhe shtrirjen territoriale të Bashkisë Maliq :*

### A. POPULLSIA

Bashkia e madhe Maliq që funksionon prej Qershorit 2015, ka një popullsi prej 62 666 banore, e ndare në 19 011 familje. Kjo Bashki sipas Njësive Administrative ndahet : Maliqi 7599 banorë (2555 familje); Njësia Administrative Libonik 13769 banorë (4053 familje); Njësia Administrative Pirq 9996 banorë (2985 familje); Njësia Administrative Pojan 16 989 banorë (5007 familje); Njësia Administrative Vreshtas 10571 banorë (3034 familje); Njësia Administrative Gore 3742 banorë (1377 familje) dhe Njësia Administrative Moglicë 1226 banorë. Rreth 12% e popullsisë jeton në qytet dhe rreth 88% jeton në fshat.

### B.SIPËRFAQJA DHE SHTRIRJA GJEOGRAFIKE

Bashkia Maliq ka një fond toke prej 42333,59 ha, nga të cilat : tokë bujqësore 24231,26 ha, are 21949 ha, pemëtari 1770,3 ha, vreshtari 463,53 ha. Zëra të tjerë : Pyje 23624 ha, Kullota 9386 ha,

Pozicioni tokës arë : Fushë 13594,57 ha, kodër 1099,85 ha, mal 1754,49 ha. Bashkia Maliq shtrihet në pjesën juglindore të Shqipërisë dhe kufizohet me këto Bashki : Në Lindje me Bashkinë Pustec, në veri me Bashkinë Pogradec, në veriperëndim me Bashkinë Gramsh, në perëndim me Bashkinë e Skraparit, në lindje me Bashkinë Devoll, në juglindje me Bashkinë Korçë. Përmes sipërfaqes kalon lumi i Devollit i cili ka ndikim në vaditjen e një pjese të fushës dhe në zonën e Njesisë Administrative Moglicë po ndërtohet një hidrocentral. Sic shikohet nga shtrirja gjeografike, kjo Bashki ka një zonë të madhe fushore ku kultivohen pothuajse të gjitha kulturat bujqësore dhe po kështu ka sipërfaqe malore jo shumë të thellë dhe një pjesë kodër. Bashkia Maliq ka 7 shkolla të mesme dhe pothuajse në çdo fshat ka shkolla fillore dhe 9 - vjecare. Në tërësi gjatë vitit kryhen mjaft aktivitete kulturore, sportive e fetare. Në bazë fshati dhe njësie administrative zhvillohen kampjone futbolli dhe theksojmë se Maliqi bën pjesë në Kampjonatin e Kategorisë së Dytë të Futbollit Shqiptar. Shtëpia e Kulturës Dhimitër Orgocka ka zhvilluar mjaft aktivitete artistike gjatë gjithë vitit. Bashkia Maliq përshkohet nga rruga nacionale Korçë-Pogradec dhe mjaft rrugë të tjera të rëndësishme si : Rruga Libonik-Zëmlak, Lapidari Podgories-Zëmlak, Maliq-Moglicë-Gramsh, etj si dhe mjaft rrugë të asfaltuara që lidhin fshatrat. Në drejtim të turizimit vendi më i frekuentueshëm është Pylli i Fazanëve, por edhe fshatrat Kolanec, Mesmal, Dushar, etj, mund të shfrytëzohen për veprimtari të tilla.

Në tërësi nuk ka probleme në fushën e rendit e qetesisë publike apo atë të kriminalitetit (gjendje normaliteti). Duhet të punohet nga strukturat e Policisë së Shtetit për zbulimin dhe goditjen e vjedhjeve sidomos në qytetin e Maliqit si dhe për kontrollin e territorit për të mos lejuar kultivimin e bimëve narkotike.

## **Neni 2**

### **Qëllimi i Rregullores :**

Qëllimi parësor i kësaj rregulloreje është të shërbejë si mjet reference për komunitetin dhe partnerët e angazhuar për ndërmarrjen e vendimeve në funksionimin e KVSP, si dhe krijimin e një ambjenti të sigurt përmes parandalimit, reduktimit dhe kufizimit të faktorëve social dhe mjedisor që ndikojnë në sigurinë në komunitetin e Bashkisë Maliq.

Rregullorja synon të theksojë se ekzistojnë politika efektive në nivel vendor dhe veprime përmes të cilave mund të reduktohen sjelljet deviante në shoqëri, rritjen e nivelit të sigurisë dhe të nxiten qytetarët për të bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse për siguri.

Rregullorja sqaron rëndësinë e konceptit të sigurisë në territorin në administrimin e Bashkisë, policimin në komunitet, rolin dhe përgjegjësitë e KVSP, objektivat si dhe detyrat e anëtarëve të KVSP-së.

## **Neni 3**

### **Objekti :**

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i përbërjes, detyrave, përgjegjësiave, mënyrën e funksionimit të KVSP ngritur pranë Bashkisë Maliq. Ky është një organ konsultativ për çështje të sigurisë, që në bashkëpunim me policinë dhe institucione të tjera sigurie, shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë, në të mirë të Bashkisë Maliq. KVSP duhet të përqëndrohet në gjetjen e shkaqeve të faktorëve destabilizues. Parandalimi i dukurive negative duhet të përqëndrohet në zvogëlimin e rrezikut të shfaqur të krimiit dhe ngjarjeve shqetësuese për bashkinë duke policuar në komunitet. Sic është përshkruar Departamenti Amerikan i Drejtësisë, “policimi në komunitet” promovon zhvillimin e strategjive që mbështesin partneritetin sistematik dhe teknikat e përshtatshme për zgjidhjen e problemeve, si dhe trajton në mënyrë proaktive çështjet e sigurisë sic janë, krimi, frika nga krimi, crregullimi social apo fenomene të tjera që mund të ndikojnë në jetën dhe aktivitetin e qytetarëve.

## **Neni 4**

### **Baza Ligjore**

Aktet ligjore kombëtare janë :

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 29/1 ;

Ligji Nr.108/2014 “Policinë e Shtetit nenet 11/3 pika d dhe 78/2 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Plani veprimit.

Ligji Nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

## **Neni 5**

### **Përbërja e KVSP**

Përbërja e Këshillit Vendor për Sigurinë Publike është si më poshtë :

Kryetari i Bashkisë, në mungesë të tij nënkryetari

Administratorët e Njësive Administrative

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Shefi Komisarariatit të Policisë

Përfaqësues nga Gjykata dhe Prokuroria

Shefi i Emergjencave Civile për Bashkinë

Njësia për mbrojtjen e femijëve dhe dhunën në familje e Bashkisë

Drejtori Shëndetit Publik

Oficeri i Policisë i caktuar për dhunën në familje

Nga një përfaqësues i secilës parti politike me përfaqësim në Këshillin Bashkiak

Nga një përfaqësues i secilës bashkësi fetare

Nga një përfaqësues i cdo komuniteti etnik

Përfaqësues të Shoqërisë Civile (që përfshin organizatat rinore, organizatat e grave, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe organizatat joqeveritare).

## **Neni 6**

### **Detyrat dhe përgjegjësite**

Detyrat e **Kryetarit** të Këshillit :

Kryetari i Bashkisë është kryesuesi i KVSP-së

Kryesuesi i KVSP-së përgatit materialin për Këshillin Bashkiak mbi diskutimet, rezultatet, rekomandimet dhe vendimet pas cdo takimi të KVSP-së

Informon Këshillin Bashkiak dy herë në vit për aktivitetet e KVSP-së

Përcakton një person përgjegjës (Sekretarin e Këshillit Bashkiak), për të koordinuar mbledhjet e Këshillit, përgatitjen e dokumentave dhe shpërndarjen e tyre brenda 5 ditëve si dhe mbajtjen e minutazhit të diskutimeve.

### **Përgjegjësite**

Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin që ka në juridiksion Bashkia.

Përgatitja e planit dhe zhvillimit të projekteve vjetore të punës në mënyrë që të rritet dhe të përmirësohet siguria në komunitet, i cili i paraqitet Këshillit të Bashkisë për miratim.

Identifikimi i problematikave të cilat rrezikojnë sigurinë e komunitetit dhe rekomandimi për hartimin e një Plani Veprimi.

Bashkëpunimi me Komisaratin e Policisë dhe insitucionet e tjera për të parandaluar veprimet të cilat rrezikojnë sigurinë e komunitetit.

Të ftojë në mbledhjet e tij aktorë apo përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit;

Të kërkojë nga OJF-të apo Organizata Qeveritare financim të projekteve lidhur me sigurinë e komunitetit;

Të kërkojë nga Komisarati i Policisë të përgjigjet për rastet e rëndësishme dhe problematikat që lidhen me sigurinë në komunitet, pa ndërhyrë në çështje të hetimit.

## **Neni 7**

### **Rregullat e mbledhjes**

Mbledhjet e KVSP-ëve përcaktohen dhe kryesohen nga Kryetari i Bashkisë. Ai thërret mbledhjet dhe përkujdeset për caktimin e rendit të ditës në konsultim me anëtarët e KVSP-së.

Mbledhjet e Këshillit mund të thirren edhe me kërkesën e shumicës së anëtarëve të KVSP-së si mbledhje të jashtëzakonshme.

Këshilli zhvillon punën e vet në bazë të rendit të ditës të miratuar nga anëtarët e KVSP-së.

Procesverbalit që mbahet në takimet e KVSP-së, futet në dosje dhe duhet të jetë i disponueshëm për anëtarët e Këshillit Bashkiak, sipas nevojës dhe kërkesës. Një kopje e procesverbalit i dërgohet edhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

KVSP-ja mund të mbajë mbledhjet, nëse në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve dhe nëse për rekomandimet e propozuara votojnë shumica e të pranishmëve. Në rast të rezultatit të barabartë të votimit, vota e kryesuesit është vendimtare.

Në mbledhjet e KVSP-së diskutime për çështjet e shtruar sipas rendit të ditës dhe çështje të tjera me interes, për siguri të komunitetit mund të zgjasin 5 minuta.

Cdo anëtar i tij, ka të drejtë që për të njëjtën çështje të diskutojnë vetëm një herë.

Anëtarët e KVSP-së, nuk duhet të ndërpresin fjalën e kryesuesit të mbledhjes ose të diskutimeve të tjera, të përdorin fjalë ofenduese, të ndërmarrin sulme personale apo veprime nga ndonjë anëtar, të përhapin informacione që çenojnë jetën private të cdo anëtar, të sillen në mënyrë të pa denjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset ku mbahet mbledhja, etj.

## **Neni 8**

### **Objektivat**

Objektivat e KVSP-së janë formuluar për të dhënë përgjigje ndaj çështjeve të sigurisë që duhen adresuar. Sipas rekomandimeve ka 5 objektiva kryesore :

Rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitet.

Identifikimi i shqetësimeve lidhur me sigurinë publike.

Rekomandimin e planit të veprimit dhe adresimi i shqetësimeve të qytetarëve tek autoritetet lokale përgjegjëse.

Ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në cdo bashkësi.

Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve për çështjet e krimit dhe çështje të tjera që lidhen me kualitetin e jetës.

## **Neni 9**

### **Identifikimi i problemeve dhe rekomandimi i planeve të veprimit**

Identifikimi i problemeve rreth sigurisë në komunitet është njëra nga detyrat kryesore të KVSP-së. shumë shqetësime për sigurinë, janë të njohura nga aspekti i përgjithshëm, përfliten si dukuri që qytetarët janë të prekur, mirëpo adresimi i tyre jo rrallë nuk është adekuat.

KVSP-ja duhet të sigurojë metoda dhe mjete të përshtatshme për krijimin e kontakteve të rregullta me qytetarët. Ata duhet të jenë të informuar për ekzistencën e KVSP-së dhe të kenë adresë të saktë ku paraqesin shqetësimet e tyre.

## **Neni 10**

### **Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit**

Policia e Shtetit ka rol kyc për sigurinë në komunitetet, ndërsa KVSP-ja është një mekanizëm i duhur për ndërtimin e një besimi reciprok në mes të qytetarëve dhe policisë. Bashkëpunimi ndikon në ndërtimin e një besimi të qytetarëve tek organet e rendit, forcon ndjenjën e sigurisë në mjedisin ku jetojnë, u

mundëson banorëve ambient të sigurt, siguron zbatimin e ligjit e për rrjedhojë qytetarët paraqesin lirshëm problemet e tyre te policia.

Disa nga format e bashkëpunimit me policinë me qëllim rritjen e sigurisë në komunitet:

Shkëmbimi i informacioneve rreth problemeve të sigurisë;

Konsultimi për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në komunitet;

Takime të rregullta midis pushtetit vendor dhe policisë;

Pjesëmarrja e rregullt e organeve të policisë në takimet me KVSP-në.

Bashkëpunimi me grupet e interesit dhe policisë;

Prezenca e rregullt e policisë në zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak;

Zbatimi i rekomandimeve të KVSP-së për atë që mund të ndikojë policia;

Zbatimi i rekomandimeve të policisë për çështjet e sigurisë nga pushteti vendor për atë që ka të bëjë nëpërmjet kompetencave të saj;

Informimi publik;

Inkurajimi i komunitetit për të identifikuar dhe adresuar shqetësimet dhe pikëpamjet e veta në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me kriminalitetin dhe zvogëlimin e mosbesimit nga ata;

Mbështetjes dhe inkurajimit të iniciativave për siguri, me qëllim të parandalimit të kriminalitetit dhe bashkëpunim të qëndrueshëm;

Pjesëmarrje në hartimin e projekteve për sigurimin e burimeve financiare për zbatimin dhe monitorimin e të gjitha iniciativave dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me sigurinë.

## **Neni 11**

### **Masat disiplinore**

Masat disiplinore që mund të përdoren për anëtarët që shkelin nenin 7 të këtij akti janë :

a.Tërheqje vëmendje;

b.Vërejtje;

c.Ndërprerja e fjalës;

d.Përrjashtim nga seanca e mbledhjes.



## Neni 12

### Gjuha e përdorur

Mbledhjet e KVSP-së mbahen në gjuhën shqipe, duke siguruar përkthimin e përshtatshëm, sipas nevojës dhe në gjuhën e komuniteteve të tjera në rast se ka.

## Neni 13

### Dispozita kalimtare

- 1-Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë Rregullore do të bëhen sipas procedurës së nxjerjes së saj.
- 2-Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Bashkiak i Maliqit.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gëzim TOPÇIU**

